



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Seancë dëgjimore me kryetarin e Entit Rregullator të Energjisë, zotin Petrit Ahmeti, lidhur me shqyrtimin e raportit vjetor të Entit për vitin 2018 (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Andrea Marto, Arben Pëllumbi, Dritan Bici, Eglantina Gjermani, Gjetan Gjetani, Ilir Beqaj, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Rrahman Rraja, Nimet Musaj dhe Arlind Çaçani.

Mungojnë:

Lefter Koka.

Të ftuar:

Petrit Ahmeti - Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë ERE

Rajmonda Islamaj – anëtare e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë

Erjola Sadushi - anëtare e Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë

Maksim Shuli – anëtar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë

Adriatik Bego – anëtar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Përshëndetje, kolegë deputetë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me kryetarin e Entit Rregullator të Energjisë, zotin Petrit Ahmeti, lidhur me shqyrtimin e raportit vjetor të Entit për vitin 2018. Relator për këtë raport është zoti Pëllumbi.

Të ftuar nga Enti Rregullator i Energjisë kemi zonjën Rajmonda Islamaj, zonjën Erjola Sadushi, zotin Maksim Shuli dhe zotin Adriatik Bego.

Fjalën e ka zoti Ahmeti për të bërë një prezantim të shkurtër të raportit. Më pas fjala do të jetë për relatorin, zotin Pëllumbi, dhe më pas për anëtarët e tjerë për të bërë pyetje dhe diskutime rreth raportit.

Faleminderit!

Petrit Ahmeti – Faleminderit, zoti kryetar!

Në dallim nga vitet e tjera, këtë herë menduam që të jetë prezent i gjithë Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, qoftë në prezantimin fizik të raportit, por edhe në përmbajtjen që duam të paraqesim lidhur me raportin vjetor të vitit të kaluar.

Në këtë raport kemi synuar të japim një pasqyrë të plotë dhe sa më të detajuar për gjendjen e sektorit të energjisë elektrike dhe sektorit të gazit natyror në vendin tonë, si dhe vështirësitë, sfidat apo arritjet, me të cilat këta sektorë janë përballur gjatë vitit 2018. Po ashtu, pjesë e këtij raporti është edhe informacioni i përditësuar për aktivitetin e shoqërive, të cilat operojnë në këta dy sektorë.

Më duhet të theksoj se viti 2018 ka qenë një vit i mbushur me sfida dhe përpjekje të rëndësishme. Në çdo rast janë mbajtur parasysh parimet themelore të mbrojtjes së klientëve, të transparencës dhe ekuilibrit të interesave të konsumatorëve, investitorëve privatë dhe shtetit, si dhe angazhimet e ndërmarra nga ana e shtetit shqiptar në arenën rajonale dhe atë ndërkombëtare.

Dëshiroj t'ju informoj se gjatë vitit 2018, sektori i energjisë ka pasur një qëndrueshmëri në aktivitetin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke mbajtur dhe duke ruajtur parametra të qëndrueshëm operimi dhe rezultate të mira financiare. Megjithatë, mbetet shumë për të bërë në drejtim të diversifikimit të burimeve

gjeneruese dhe adresimit të çështjeve, si dhe zgjidhjeve sa më efeciente në drejtim të mbështetjes së zhvillimit të burimeve gjeneruese të rinovueshme.

Gjatë vitit 2018 janë shtuar burimet gjeneruese të rinovueshme, të cilat aktualisht zënë rreth 32 % të totalit të burimeve tona gjeneruese. Po ashtu, edhe sektori i gazit natyror ka shënuar zhvillime efikase në strukturimin e tij dhe funksionimin normal, ku një rol të rëndësishëm ka luajtur ecuria e investimit të projektit “TAP”, brenda afateve të përcaktuara për vënien në operim të tij.

Në vijim të procedurave të certifikimit dhe licencimit të shoqërisë “Albgaz” sh.a, është punuar ngushtësisht në kuadër të implementimit të vendimeve të grupit të përhershëm të nivelit të lartë të Komunitetit të Energjisë, ku, ndër të tjera, përfshihen: krijimi i kodit të rrjetit për mekanizmin e alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit, si dhe krijimi i kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror, që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit.

Enti Rregullator i Energjisë ka zhvilluar veprimtarinë e tij, duke u mbështetur në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar”” dhe në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar””.

Realizimi i pavarësisë organizative dhe funksionale të institucionit ka qenë dhe mbetet një objektiv i vazhdueshëm dhe kryesor i institucionit, gjë që ka rritur më shumë kërkesën për një kualifikim më të lartë profesional dhe përgjegjshmëri më të madhe në vendimmarrje, por paralelisht edhe me nevojën eminente të zgjerimit të stafit mbështetës teknik për realizimin e qëllimit dhe sfidave, që sjellin angazhimet në kuadër të integritetit në tregun rajonal.

Gjatë vitit 2018 jemi munduar të ndërthurim eksperiencën dhe profesionalizmin e ekspertëve tanë me eksperiencën më të mirë të organizmave simotra rajonalë dhe paneuropianë, në disa prej të cilëve jemi edhe anëtarë me të drejta të plota. Ky bashkëpunim ka rezultuar mjaft i frytshëm dhe kam bindjen se do të vijojë të japë në të ardhmen më shumë rezultate, si në shkëmbimin e eksperiencave, ashtu edhe në përmirësimin e aftësive teknike të stafit tonë, duke rritur rolin aktiv të ERE-s në rajon e më gjerë.

Shqipëria është në rrugën e saj të sigurt drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ndaj, puna jonë ka si qëllim kryesor zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në përputhje me kërkesat rregullatore dhe legislative, të cilat duhet të përputhen plotësisht me ato të BE-së. Këto zhvillime kërkojnë që ERE-ja të zhvillohet si një institucion me kapacitete teknike të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t’u përballur me sfidat e sektorit në Shqipëri e më gjerë.

Për këtë arsye një rëndësi të veçantë i kemi dhënë zhvillimit të strukturës organizative të ERE-s, si dhe pavarësisë operationale të stafit të saj për t'i përballuar me sukses sfidat e sektorit në përmbushjen e detyrave, që dalin nga zbatimi i rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, detyrave që dalin në drejtim të krijimit të tregjeve rajonale në vendet e Europës Juglindore dhe më gjerë, si në sektorin e energjisë elektrike, ashtu dhe në atë të gazit natyror.

Nga analiza që u është bërë disa treguesve kryesorë të sistemit energjetik, si prodhimi i energjisë elektrike, duhet thënë se viti 2018 ka shënuar një rritje të prodhimit të energjisë, ndër të cilat, do të theksoja:

- Gjatë vitit 2018 janë shtuar 11 HEC-e të reja me kapacitete të instaluar prej 38,3 megavat, të cilat kanë prodhuar rreth 19 gigavat/orë energji elektrike.

- Prodhimi i përgjithshëm i vendit ka qenë në nivelin 8,5 teravat/orë, më i larti që nga viti 1985, prej të cilave vetëm 68,31% është prodhuar nga shoqëria publike e gjenerimit, kurse pjesa tjetër është prodhuar nga sektori privat i prodhimit të energjisë elektrike.

- Viti 2018 ka qenë një vit eksportues për vendin tonë me eksporte që arritën vlerën 913 megavat/orë, duke i krijuar kompanisë së gjenerimit publik të ardhura shtesë përveç të ardhurave, që lidhen me shitjet e energjisë elektrike te Furnizuesi i Shërbimit Universal.

- Humbjet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike kanë qenë në nivelin 23,96%, krahasuar me 26,41 % të një viti më parë.

- Konsumi ka pasur një rritje me 2,7%, krahasuar me vitin 2017, duke arritur vlerat mbi 7,6 teravat/orë.

Viti hidrik i mbarë dhe zbatimi i disa prej reformave në këta sektorë kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike të klientëve për vitin që lamë pas.

ERE-ja ka pasur si mision kryesor kryerjen e shërbimeve të sigurt dhe të besueshme për klientët, bazuar në kosto sa më të drejta dhe të arsyeshme për të licencuarit. Kjo gjë është reflektuar në vendimmarrjet për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike.

Në fushën e gazit natyror ka vazhduar bashkëpunimi me dy ente, rregullatore, Greqisë dhe Italisë, në të cilat kalon projekti i TAP-it, si dhe është mundësuar licencimi i projektit TAP, si kushti paraprak për vënien në operim të tij. Duke e konsideruar faktin se ende mbetet për t'u punuar në drejtim të kuadrit rregullator me akte nënligjore, të përcaktuara në ligjet që rregullojnë sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Për vitin që vjen objektivat e ERE-s do të vijojnë të orientohen drejt plotësimit të legjislacionit me aktet përkatëse. Kjo lidhet ngushtë edhe me mbështetjen e liberalizimit të mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike, të ngritjes dhe operimit efikas të bursës së energjisë elektrike, për sa është në kompetencë të ERE-s, dhe mbikëqyrjes së tij për rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe zbutjen e efekteve të klientët fundorë në fillimet e operimit të tij.

Në këtë prizëm, ERE-ja është tërësisht e angazhuar për të bashkëpunuar ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, si një ndër partnerët kryesorë në përpilimin e legjislacionit primar dhe sekondar, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe të gjithë aktorët e tjerë të sektorit energjetik në vend e më gjerë.

Gjykoj se ky bashkëpunim është shumë thelbësor për zhvillimin e këtij sektori në të ardhmen dhe për përballimin e sfidave, që na dalin para në kuadër të bashkimit me tregjet rajonale, si dhe në kuadër të angazhimeve të ndërmarra tashmë nga ana e qeverisë shqiptare në këtë drejtim.

Me gjithë arritjet apo përmirësimet e përshkruara në këtë raport, puna jonë në vijim do të fokusohet më tepër në çështjet, që lidhen me hapjen e tregut të sektorit të energjisë elektrike të klientët fundorë; me ndarjen ligjore të OSHEE-së, sipas parashikimeve të ligjit; me uljen e riskut për të mundësuar parandalimin e rrezikut të sigurisë së furnizimit me energji elektrike të popullatës në një vit relativisht të thatë, si dhe përpilimin e legjislacionit sekondar për të paraprirë mundësinë e krijimit të një tregu të gazit natyror në Shqipëri dhe shfrytëzimit të hapësirave, që krijon përfundimi i projektit TAP për realizimin e projekteve të tjera rajonale, siç është ai *Ionian Adriatic Pipeline*.

Në punën tonë një vend të rëndësishëm dhe prioritar ka zënë edhe transparenca e sektorit. Për këtë ne jemi munduar, besoj se ia kemi arritur, të krijojmë kushte për rritjen e transparencës për të mundësuar ekuilibrimin e interesave të klientëve fundorë, kompanive publike, si dhe investitorëve privatë në sektorët e rregulluar nga ana jonë.

Në kuadër të transparencës, ky raport vjetor do të jetë në dispozicion të të gjitha institucioneve, të investitorëve, por edhe të konsumatorëve që janë të interesuar, në faqen zyrtare të ERE-s në internet.

Së fundi, me këtë rast dëshiroj të falënderoj të gjithë stafin e ERE-s, si dhe të gjitha institucionet përkatëse për mbështetjen dhe bashkëpunimin!

Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj Kuvendin e Shqipërisë, por edhe konsumatorët shqiptarë, të cilët në çdo rast kanë pasur akses të sigurt në praktikat e shqyrtuara dhe miratuara nga ana jonë, me qëllim marrjen e opinionit të tyre, gjë që është

adresuar edhe nëpërmjet shoqatave për mbrojtjen e konsumatorit, si dhe në bashkëpunimin konstant me Autoritetin e Konkurrencës! Unë jam i bindur për vazhdimin e këtij bashkëpunimi të frytshëm edhe në të ardhmen.

Kjo ishte pak a shumë një përmbledhje e sintetizuar e raportit vjetor, që ne kemi paraqitur pranë Kuvendit të Shqipërisë. Natyrisht, në këtë raport janë trajtuar shumë çështje, të cilat paraqesin në mënyrë të detajuar zhvillimin e këtij sektori në vendin tonë. Gjithashtu, është paraqitur në mënyrë të detajuar edhe aktiviteti i ERE-s, që lidhet me organizmat ndërkombëtarë dhe me përfaqësimin tonë në të gjitha strukturat e vendeve të Mesdheut, por edhe të vendeve të Europës Juglindore.

Gjithsesi, së bashku me kolegët e tjerë që përfaqësojnë Bordin Rregullator të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror të ERE-s, jemi në dispozicion për çdo pyetje, sugjerim apo sqarime të mundshme.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Ahmeti.

Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ahmeti, për parashtrimin!

Ne kemi përgatitur një material, i cili ndahet në tri pjesë: në pjesën e parë kemi një analizë të detyrave, që ishin lënë për ERE-n për vitin 2018 dhe si kanë ecur ato; në pjesën e dytë kemi bërë një analizë të gjetjeve, vlerësimeve dhe problematikave të raporteve ndërkombëtare në fushën e energjisë, sidomos duke u mbështetur në raportin e progresit të Komisionit Europian; në pjesën e tretë kemi një dokument për sa i përket performancës së ERE-s lidhur me gjetjet, problematikat dhe vlerësimet si gjatë vitit 2018, ashtu edhe rekomandimet që kemi për vitin 2019.

Fillimisht dua të them se raporti i paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë në datën 02.05.2019 është në tejkalim të afateve ligjore, edhe falë shtyrjes që ju keni kërkuar. Më lejoni shkurtimisht të them disa nga gjetjet që kemi në raportin e vitit 2018.

Në lidhje me rikuperimin e vonësave të krijuara dhe bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nga ai i Furnizimit të Shërbimit Universal, ndarje e realizuar së fundi me themelimin e tri shoqërive aksionare: Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a, Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a, dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a, vërejmë se ky rekomandim nuk është realizuar.

ERE-ja duhej të ishte treguar më e kujdesshme dhe duhej ta kishte analizuar më mirë situatën në vendimet e marra për licencimin dhe transformimin e licencave për muajt shtator–

tetor 2018, pasi vetëm dy muaj më pas mori vendimin për pezullimin e këtyre licencave dhe miratoi periudhën transitore 12-mujore.

OSHEE-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë dhe ERE-n duhej të kishin bërë paraprakisht përcaktimin e saktë të strukturave organizative dhe proceseve të menaxhimit të portofolit të energjisë elektrike, në përputhje me funksionet dhe veprimtarinë që do të mbulojë çdo operator dhe më tej do të vijonte me kërkesën për licencimet e shoqërive.

Gjatë periudhës transitore ERE-ja duhet të lunte një rol proaktiv për përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore respektive për bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të OSHEE-së. Gjithashtu, duhej të kishte bashkëpunuar me Ministrinë e Industrisë dhe Energjisë dhe me Sekretariatit të Energjisë për marrjen e masave të nevojshme për monitorimin e ndarjes së OSHEE-së, sipas parashikimeve ligjore, proces i cili duhej të shoqërohej me ndarjen funksionale, organizative, si dhe të llogarive dhe kostove ndërmjet furnizuesit të fundit të OSHEE-së, duke mundësuar shërbim të sigurt dhe me cilësi të klientëve fundorë.

Në lidhje me rritjen e përpjekjeve dhe të bashkëpunimit me institucionet përkatëse, për të mundësuar ngritjen dhe bërjen efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë, vërejmë se ky rekomandim është realizuar pjesërisht.

ERE-ja ka bashkëpunuar, nëpërmjet përfaqësuesve të saj, me të tria grupet e punës së ngritur, me qëllim bërjen efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë. Gjithashtu, ka miratuar memorandumit të mirëkuptimit për bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike ndërmjet palëve. Nga ana tjetër, duhet theksuar se krahas përpjekjeve dhe bashkëpunimit për hapjen e Bursës Shqiptare të Energjisë, duhej të punonte edhe për kryerjen e një studimi për impaktin afatshkurtër lidhur me një rritje të mundshme të çmimit të energjisë të klientët familjarë dhe masat që duhej të merrte për amortizimin e këtij efekti të klienti fundor, si rezultat i hapjes së tregut të energjisë elektrike dhe bashkimit të tregjeve të vendeve të Europës Juglindore me ato europiane.

Në lidhje me propozimin për ndryshimet në strukturën e saj organizative, për të bërë të mundur sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t'u përballur me sfidat e sektorit, vërejmë se ky rekomandim është realizuar.

ERE-ja e ka zhvilluar aktivitetin e saj me një strukturë të miratuar në vitin 2008 dhe në të gjitha raportet ndërkombëtare, përfshi edhe raport-progresin, raportin e Sekretariatit të Energjisë, si dhe në misionet e ekspertëve të BE-së, është theksuar domosdoshmëria e rritjes së kapaciteteve të ERE-s.

Në vijim të vitit 2019 ERE-ja duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë implementimit të strukturës së miratuar dhe rekrutimit të një stafi sa më të aftë profesional për të përballuar sfidat e sektorit, i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së punës dhe pavarësisë operacionale të ERE-s.

Në lidhje me bashkëpunimin që duhet të kishte me OSHEE-në dhe institucionet përgjegjëse për marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të pronësisë të kabinave elektrike, 51,3% e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE-së, vërejmë se ky rekomandim nuk është realizuar. Sipas ERE-s ndryshimet e nevojshme në legjislacion për zgjidhjen e këtyre problematikave janë në diskrecion të OSHEE sh.a.

Sidoqoftë, ERE-ja duhet të kishte kryer veprime konkrete dhe të ofronte ekspertizën e saj dhe jo thjesht të mjaftohej me dërgimin e një shkrese zyrtare për OSHEE-në, ku i kërkonte asaj të bënte propozimet përkatëse.

Për sa u përket masave të marra për të bërë të mundur një vlerësim të plotë të humbjeve të OSHEE-së nga pika e lidhjes së prodhuesve të energjisë, në mënyrë që të kishte një sistem sa më të drejtë dhe të saktë për shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, vërejmë se ky rekomandim nuk është realizuar.

Me gjithë kohën pothuajse njëvjeçare, që ka pasur në dispozicion dhe hapat e ndërmarra nga OSHEE-ja për kryerjen e studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësia gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE-së, ai ende nuk ka përfunduar.

Ky rekomandim duhet të përmbushet në vitin 2019, ku, pas propozimeve që do të dërgohen nga OSHEE-ja lidhur me këtë problem, ERE-ja duhet të bëjë vlerësimet përkatëse dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm.

Në lidhje me nxitjen e OSHEE-në për vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, vërejmë se është një rekomandim që nuk është përmbushur. ERE-ja duhet të caktojë afate konkrete për këtë çështje dhe jo të mjaftohet me një shkresë zyrtare të dërguar në muajin shtator.

Për sa i përket fokusit për plotësimin e kuadrit ligjor me legjislacionin sekondar në funksion të vendimeve të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe ndryshimeve që ka pësuar ky ligj, vërejmë se është një rekomandim i realizuar. Në vijim, ERE-ja duhet të vazhdojë plotësimin e kuadrit ligjor me legjislacionin sekondar.

Për sa i përket procesit të shqyrtimit dhe miratimit të planit të investimeve të operatorëve shpërndarës dhe të transmetimit të energjisë, duke kërkuar nga ana e tyre

orientimin e investimeve drejt uljes së kostove, vërejmë se është një rekomandim i realizuar. Në vijim, ERE-ja duhet të vazhdojë të monitorojë zbatimin e planeve të OST-së dhe OSHEE-së.

Për sa i përket bashkëpunimit në vazhdimësi me komunitetin e energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës për çështjet që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, vërejmë që është një rekomandim i realizuar. Në vijim, ERE-ja duhet të vazhdojë bashkëpunimin me komunitetin e energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës.

Për sa i përket vijimit të punës për reflektimin në legjislacionin aktual rregullator të ndryshimeve të nevojshme në përputhje me paketën e tretë të Bashkimit European në fushën e energjisë, për të bërë të mundur krijimin e një tregu konkurrues, eficient, që nxit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike, vërejmë që është një rekomandim i realizuar. Në vijim, ERE-ja duhet të vazhdojë reflektimin në legjislacionin aktual të ndryshimeve të nevojshme në përputhje me paktin e tretë të Bashkimit European në fushën e energjisë.

Për sa i përket rritjes së përpjekjeve në luajtjen e rolit proaktiv për liberalizimin aktual gradual dhe hapjen efektive të tregut të energjisë për të siguruar shërbime të drejta dhe të besueshme për klientët, që rrisin konkurrencën në tregun e energjisë elektrike, vërejmë që është një rekomandim, i cili duhet të vijojë të ndiqet me prioritet nga ERE-ja përgjatë vitit 2019.

Për sa i përket vijimit të punës për zhvillimin e tregut të gazit, si një kusht i rëndësishëm për të garantuar sigurinë afatgjatë të furnizimit me gaz natyror dhe diversifikimin e burimeve në vend, vërejmë që është një rekomandim i realizuar. Në vijim, ERE-ja duhet të vazhdojë punën për zhvillimin e tregut të gazit natyror.

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, përmes kompetencave që i jep ligji, të kërkojë nga OSHEE-ja respektimin e të drejtave të konsumatorit, përmirësimin e shërbimit të kujdesit për klientit, evidentimin dhe ndëshkimin e sjelljeve arbitrare dhe të papërgjegjshme nga punonjës të OSHEE-së, si dhe respektimin e afateve për shërbimet përkatëse, vërejmë se me gjithë uljen e numrit të ankesave pranë ERE-s, duhet bërë më shumë nga ERE-ja përmes kompetencave që i jep ligji në mbrojtjen e konsumatorit për mosrespektimin e afateve për shërbimet përkatëse, për sjelljet arbitrare dhe të papërgjegjshme ndaj klientëve, pasi vijnë të mbeten problem.

OSHEE-ja duhet të ofrojë një qasje të re për shërbimin e kujdesit ndaj klientit, të vijojë t'i kushtojë një vëmendje të veçantë kujdesit për mbrojtjen e interesit të klientëve, duke trajtuar jo vetëm ankesat e përcjella për kompetencë nga ERE-ja, por duke marrë pjesë në

proceset gjyqësore, në të cilat klientët ushtrojnë të drejtën kushtetuese për ankesa ndaj operatorit të shpërndarjes. Ky është një rekomandim, i cili duhet të vijojë të ndiqet me prioritet nga ERE-ja gjatë vitit 2019 në kushtet e një tregu monopol të shpërndarjes së energjisë elektrike për klientët e tensionit të ulët.

Gjithashtu, të rrisë përpjekjet në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike përmes publikimit në faqen *online* të institucionit, sepse vëmë re që në raport nuk ka asgjë shpjeguese për këtë pikë.

Zoti kryetar dhe anëtarë të komisionit, në përgjithësi këto ishin disa nga gjetjet që ne menduam të veçojmë në raportin vjetor të Entit Rregullator për vitin 2018, të cilat do t'i kemi parasysh edhe në rezolutën që kemi përgatitur për vitin 2019. Nëse do të duhet ta shqyrtojmë edhe atë, kemi material gati.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Ka pyetje nga anëtarët?

Fjalën e ka zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Së pari, kam vlerësim për punën e Entit, sepse jemi në një treg me shumë interesa. Viti i kaluar ka qenë relativisht i mirë, kryesisht falë motit, siç edhe periudha e parë e këtij viti nuk është e mirë po për këtë arsye. Ne jemi ende të varur nga uji për prodhimin e energjisë. Shpresoj që këtë vit, me vënien në punë të impianteve të para që shfrytëzojnë diellin si burim energjie, do të fillojmë të kemi diversifikim.

Gjithashtu, e falënderoj ERE-n edhe për marrëdhëniet e mira që ka me komisionin tonë.

Në dy momente të para për ato që prezantoi kolegu në gjetjet e zbatimit të rekomandimeve të vitit të kaluar, në administrimin e kabinave nga OSHEE-ja, mendoj se përveç asaj që është e thënë këtu, ERE-ja, në bashkëpunim me aktorët e interesuar, ndoshta është nevoja edhe për mbështetje nga komisioni, të përpiqet të rregullojë të nesërmen. Edhe sikur t'i zgjidhim të gjitha kabinat sot, nëse vazhdojmë me këtë praktikë, pas 5 apo 10 vjetësh do të vijmë sërish në këtë pozicion. Është normale që një investitor që ndërton kabinën, sidomos kur nuk është prodhues vetë, në një bllok rezidencial do të përpiqet të shpenzojë sa më pak, ta lejë aty.

Siç e dimë ne, ata që merren me ndërtim krijojnë një sh.p.k, e cila, kur mbaron ndërtimi, nuk ekziston më dhe pas 5 vjetësh do të jemi sërish në një situatë, po themi jetime, ndaj mendoj duhet të zgjidhim jo vetëm të sotmen, por të ndërtojmë edhe një model tjetër për të ardhmen.

A e bën vetëm OSHEE-ja, gjë që unë nuk e besoj, apo duhet ndryshim ligji, vendimi e të tjera, ne me këtë punë merremi.

Për sa i përket faturimit disamujor ose me mundësinë e shfrytëzimit të sistemit të ri, teknika vërtet është e OSHEE-së, por për sa kohë se në kontratën e sotme thuhet se faturimi është 30-ditor, aty jemi. Mund t'i paraprijmë me një kontratë të miratuar nga ju 30 apo 60-ditore, këtë e dini ju, por zbatimi i saj mund të jetë, sepse duket sikur kemi hyrë në një rreth vicioz, ju prisni ata se çfarë do t'ju thonë, ata thonë ne e kemi 30-ditor. Këto lidhen me rezolutën që bëmë me vitin e kaluar.

Dy momente që unë i quaj të rëndësishëm dhe dua të marr informacion janë, e para, për herë të parë vjet në mars, nëse nuk gaboj, dolën metodologjitë e para për të marrë vetë energji në treg. Në bazë të metodologjisë, të miratuar nga ju në 4 shkurt të vitit 2017, çmimet për muajt janar, shkurt, mars dhe prill të vitit 2018 kanë qenë: 11,6; 8,85; 7,74; 6,85 dhe 7,04. Më 25 maj të vitit 2018 ju keni një vendim për një metodologji të re.

Kam dy pyetje: çfarë ju shtyu të ndryshoni metodologjinë dhe pse i dhatë fuqi prapavepruese? Ju e morët vendimin në maj, por rezultoi që në muajt janar, shkurt, mars dhe prill të vitit 2018 çmimet u kthyen 11,6 dhe pastaj 9,5; 9,5; 9,5 dhe 9,5, sepse me metodologjinë e dytë vendosët edhe një çmim dysHEME. Më pas, për situatën që kaloi gjysma e dytë e vitit, sipas metodologjisë, çmimi ka variuar nga 12,86 në 18,8 lekë. Unë mbaj mend që diku në fund të nëntorit të vitit 2018, ne si komision na ka ardhur një letër nga një sipërmarrës në Fier që prodhonte tulla, i cili ishte i shqetësuar, sepse u vu në një situatë të re, ndoshta ndryshimin për prodhimin e tullave mund ta ketë me kosto të ndjeshme, kishte kredi dhe u vu para një rritjeje kostoje, ndoshta i papërgatitur që në ekonominë e tregut, me liberalizimin e çmimit, do të ketë kaq shumë ndryshime.

E dyta, kemi bërë një diskutim para pak javësh, ku ishit prezent ju dhe sekretari i Sekretariatit të Energjisë. Para një viti më kanë lindur disa rezerva për parashtesat e tij, sepse, e përsëris, kam përshtypjen se mënyra si ka prezantuar vjet dhe sivjet zotëria, i cili nuk është këtu, por unë ia kam thënë në sy, ndaj jam i qetë sot, duket sikur është më shumë i interesuar për tregtarët e energjisë, sesa për konsumatorët e energjisë. Ai ngriti shqetësimin që, me vendimin tuaj, detyrimi i OSHEE-së për të paguar faturat, nga 90 ditë, kishte kaluar në 180 ditë. Cili është legjislacioni ynë në fuqi që ju detyron ju apo ju jep të drejtën të caktoni afate, sepse në parim, në marrëdhënie tregtare, këto janë çështje që i zgjidh Kodi Tregtar.

Zotëria shprehu shqetësimin që afatet 180-ditore mund të krijojnë vështirësi tek tregtarët e energjisë, por unë kam bërë një analizë duke marrë të dhëna zyrtare nga tatimet: 14, 15, 16, 17, 18 në Shqipëri.

Të gjithë subjektet që kanë licencë te ju, janë më shumë se 100 subjekte, si: prodhues, tregtarë privatë dhe shtetërorë, ku rezulton se vjet ka qenë një situatë shumë e mirë, por raporti fitim-të ardhura në këto vite është 2,9% dhe më pas rritet në 9,2, 13,7, 10,5 dhe 24,2%. Pra, jemi në një situatë ku ky treg prodhon fitime të mira për aktorët, por, nëse shkojmë drejt liberalizimit, ku një biznesi t'i shkojë energjia papritur 18,8 lekë, kur neve na është thënë se Shqipëria trashëgon një model sovjetik, ku bën *kros apsiti* horizontal, e mban më të lartë çmimin për biznesin, që të amortizojë kostot e familjarit, duhet të ndërtojë një model në të ardhmen. Nëse ky model i ri, sot flasim për subjekte që kanë 35 kilovat...

Nëse ne do të kishim zbatuar afatet e ligjit të vitit 2015, sot do të kishim kaluar te 20-kilovat, do të bëhej një grup i madh sipërmarrësish. Unë konstatoj se sot sipërmarrësit tanë nuk janë ende të vetëdijshëm për këtë situatë, që, të paktën, brenda 1 viti financiar, duhet të ndeshen me ndryshimet e energjisë dhe me 50% kosto. Ka edhe nga ata që mund ta kenë energjinë elektrike element të rëndësishëm, si, për shembull, ata që kanë furrat e ferro-kromit.

Unë besoj se për 5 vjet kemi pasur rezultate të jashtëzakonshme në sektorin e energjisë. Nga ajo çfarë parashtruat ju, bëra një llogari të thjeshtë, ulja e humbjeve nga viti 2017 në vitin 2018 është 150 giga. Sigurisht, ka ende hapësira për të ulur humbjet, por kemi ardhur në një moment që për dekadën e ardhshme duhet të ndërtojmë një zgjidhje më të qëndrueshme, sepse jam i bindur që po kaluan edhe 200 subjekte të tjera me këtë mënyrë të liberalizimit të çmimit të energjisë, nuk janë të përgatitur në mentalitet, dhe do t'i kemi të gjithë duke protestuar, që kjo është qeveria e krimit dhe këta janë hajdutë, ndërkohë që po bëjmë atë që ka rezultuar e suksesshme, sipas direktivave të Bashkimit Europian dhe procesit të përafrimit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Zoti Ahmeti, mund të përgjigjesh për pyetjet e zotit Beqaj, pastaj vazhdojmë me pyetjet tjera.

Petrit Ahmeti – Faleminderit!

Së pari, zoti Beqaj krijoi mundësi për t'u larguar nga retorika politike dhe për këtë e komplimentoj!

Enti Rregullator është munduar të krijojë dhe të forcojë profilin profesional të tij, sepse nuk është thjesht një element i një përfaqësie politike, përkundrazi, e them me bindje të plotë se ne jemi mbështetur nga zhvillimet politike të fundit për të krijuar edhe këtë shëndoshje të sektorit energjetik për atë që kemi mundësi ose rol praktikisht në këtë gjë. Roli i Entit nuk është i vogël, sepse lidhet edhe me përgjegjësitë ligjore që ka dhe me vendimet e

konsoliduara që merr. Këto i thashë për të bërë një parantezë të përgjigjeve që do të japim si Bord i Rregullatorit.

Më vjen mirë që vlerësohet raporti vjetor edhe për aktivitetin e punës së ERE-s, e cila është pjesë e një pune mjaft të mirë që është bërë në gjithë sektorin e energjisë në Shqipëri, duke përfshirë të gjitha pjesët e tij, nëse do të flas në gjuhën teknike, siç është sistemi i gjenerimit, i transmetimit, por edhe i shpërndarjes. Pjesa e shpërndarjes ka qenë më e komprometuar për konsumatorët dhe me një problematikë relativisht të madhe. Kjo është arsyeja që ne dhe ju jemi fokusuar në këtë pjesë të sektorit. Kërkoj ndjesë, sepse duhet të kaloj te pikat e tjera.

Po e filloj me procesin e ndarjes së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Besoj se roli i Entit Rregullator në këtë proces ka qenë proaktiv. Ne kemi studiuar dhe i kemi parë me sukses të gjitha propozimet që janë bërë për ndarjen e sektorit të shpërndarjes në tri aktivitetet e tyre, por, së fundi, pasi kemi bërë edhe procedurat për licencimin e këtyre shoqërive, më vonë, kjo varet edhe nga politikat e zhvillimit të sektorit që ka vetë qeveria, është marrë një vendim për shtyrjen e fillimit të funksionimit të organizimit të sektorit mbi bazën e këtyre tri aktivitetëve të licencuara nga ana jonë dhe të ndara në mënyrë funksionale nga ana e tyre.

Rezervoj të drejtën për të thënë se kohët e fundit ka edhe disa zhvillime, që janë duke u diskutuar, për organizimin e sektorit, por nuk kam të drejtë të futem në detaje për të sqaruar se cilat janë, pasi janë në diskutim dhe nuk kanë marrë formën e tyre përfundimtare për t'u strukturuar në profilin përfundimtar të tyre.

Problemi i kabinave elektrike është i trashëguar prej vitesh. Kompania e shpërndarjes zgjeronte rrjetin duke ndërtuar linja dhe kabina elektrike, por paralelisht investitorët privatë, që ndërtonin blloqet e apartamenteve, kishin detyrimin të ndërtonin kabinat elektrike. Natyrisht, pronësia e banesave kalonte tek ato që i blinin, ndërsa kabina mbetej gjithmonë jetime. Asnjëherë investitorët privatë nuk kanë kryer shërbimin e furnizimit me energji elektrike ose shërbimet e mirëmbajtjes së këtyre kabinave. Ky proces ka vite që nuk po rregullohet. Ne kemi dialoguar me kompaninë e shpërndarjes për të gjetur modusin ligjor si mund të zhvillohet, sepse është një vlerë goxha e madhe e numrit të këtyre kabinave që kanë mbetur në mëshirë të fatit.

Gjithsesi, unë po ju them se kompania e shpërndarjes i kryen shërbimet dhe mirëmbajtjen e tyre, pavarësisht pjesës së pronësisë, sepse, në fund të fundit, ka të bëjë me furnizimin me energji elektrike të familjarëve.

Ilir Beqaj – Duhet pasur parasysh që nga ana e disiplinës financiare të OSHEE-së, trupat audituese kanë konstatuar një shpenzim të panjohur, një gjë që nuk është në inventarin e saj, kështu që çështja është më e rëndë.

Petrit Ahmeti - ERE-ja në të gjithë gjykimin që lidhet me problematikën e shpenzimeve me tarifat e ka njohur këtë shpenzim që kompania e shpërndarjes ka bërë. Pra, është më e rëndësishme ta njohë Enti Rregullator se institucionet e tjera financiare.

Prandaj, po them se këtu mbetemi në një formalizim, por ka nevojë për një angazhim të strukturave të OSHEE-së. Kjo nuk është punë e vogël, sepse numri i tyre është relativisht i madh është një procedurë që duhet kryer, por të jeni të sigurt se nga ana e Entit Rregullator njihet vlera e këtyre kabinave, kështu që nga pikëpamja financiare nuk diskutohet kjo punë, sepse është edhe detyra jonë të vendosim ekuilibra të drejta. Kërkon një zgjidhje ligjore, që ne e kemi propozuar me dy shkresa, por ky është një problem që duhet zgjidhur nga kompania e shpërndarjes në një formë ligjore më të detajuar dhe më të saktë.

Ilir Beqaj – Unë mendoj se duhet punuar në dy korsi paralele. Pra, nga 1 janari i vitit 2020, të bëhen kabina të reja, ndërsa për të tjera duhet një fare legalizimi nga e para.

Petrit Ahmeti - Në momentin që e kemi ngritur këtë problem ne kemi pasur një lloj rezerve, sepse asnjë nga këto probleme nuk janë të pazgjidhshme. Pra, siç thoni ju se ka dy rrugë paralele, natyrisht ne jemi gati të bashkëpunojmë për të gjitha llojet e zgjidhjeve. Unë jam dakord me këtë që thoni ju. E mira është që në rezolutë të vendosen detyra të qarta dhe të zbatueshme nga pikëpamja organizative dhe ligjore.

Unë nuk e shikoj të pazgjidhshme këtë gjë. Kemi pasur një dialogim me kompaninë e shpërndarjes, por ka mbetur në vullnetet e mira të të dy palëve për ta zgjidhur këtë problem dhe aq më tepër kur ne gjejmë një vullnet edhe nga ana e komisionit për ta trajtuar nga ana legislative, duke pasur parasysh që ndërtimet private edhe numri i kabinave ka për t'u shtuar. Unë jam dakord me propozimin e zotit Beqaj, që tani të bëjmë një propozim për të zgjidhur ato që do të ndodhin, por ama të zgjidhet edhe situata ekzistuese.

Dua të theksoj se çdo vlerë e kësaj kabine nuk ngarkohet artificialisht te pjesa e shpërndarjes, por konsiderohet e gjitha në vlerësimet që ne bëjmë si ent rregullator, sepse janë ngarkesa financiare që duhet t'i marrim parasysh.

Niko Peleshi - Zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Zoti Ahmetaj, jam përpjekur të gjej një shifër, por nuk e kam gjetur asgjekundi, prandaj desha të di nga ju sa është vlera e këtyre kabinave që janë pronë private?

Petrit Ahmeti- Kjo shifër mund të përlogaritet shumë shpejt, por që besoj se nesër mund ta japim.

Robert Bitri - Ta jap unë shifrën, është 16 mijë euro.

Rajmonda Islamaj – Pa truallin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Ahmeti – Firma merr përsipër për të pasur një tension më të mirë, por në të vërtetë OSSHE-ja mund të mbajë një qëndrim, sipas të cilit t'ia njohë shërbimin dhe çdo firmë të bjerë dakord me një çmim më të reduktuar, kështu të dyja palët kanë interes.

Robert Bitri - Unë kam një shqetësim në lidhje me likuidimin e kamatëvonesave dhe aforfeve. A keni ju një studim për heqjen e kamatëvonesave për abonentët familjarë? Sepse, sipas kontratave që ata kanë lidhur i bie të jenë debitorë gjatë gjithë jetës. Ne e dimë si janë vendosur këto shuma të faturuara para vitit 2013, kur edhe pse i kishin të regjistruara në librezë ato, tek OSHEE-ja regjistronin sikur ishin pa likuiduar.

Niko Peleshi - A ka pyetje të tjera?

Petrit Ahmeti- Aktualisht ne nuk kemi pranuar më faturime aforfe nga kompania e shpërndarjes. Ju keni të drejtë se ky problem është i trashëguar, por është vendim i kompanisë për të marrë vendime të kësaj natyre. Ne nuk kemi lejuar më që kompania të vazhdojë me faturime aforfe.

Nga praktika e mëparshme ka pasur shumë abuzime me problemin e faturimeve aforfe ndaj klientit. Ne kemi marrë një vendim që nuk i njohim faturat aforfe nga kompania. Ka probleme, sepse është një sektor ku punojnë mijëra punonjës, por masat e marra nga Enti Rregullator janë të tilla që të mos lejojnë më ligjërisht krijimin e një problematike të tillë. Ka problematika të trashëguara, por natyrisht ne e pamë të arsyeshme që ta ndalojmë këtë. Ky fenomen nuk do të ndodhë më. Ju falënderoj për pyetjen që më bëtë, sepse është e mirë ta dijtë edhe publiku, sepse, në fakt, vuajmë edhe nga kjo pjesë, nga publikimi i vendimeve.

Në praktikën tonë kemi filluar shumë praktika që lidhen me të drejtat e klientëve, jo thjeshtë për informimin e tyre por edhe të drejtën që ata kanë në raport me kompaninë e shpërndarjes. Kemi trashëguar një legjislacion sekondar ku kompania e shpërndarjes duke u nisur edhe nga fenomene politike të mëparshme ka pasur shumë të drejta ndërsa ato të klientit kanë qenë disi të limituara. Nga kjo pikëpamje ne po punojmë që edhe interesat e klientëve të përfaqësohen mjaft mirë në raport me kompaninë e shpërndarjes.

Rrahman Rraja – Unë, në fakt, fola për kamatëvonesat, sepse sipas një rasti që unë di, një individ ka 6 milionë lekë të vjetër për të paguar, ka lidhur kontratë me OSHEE-në për 12 mijë lekë të vjetra, por i bie që të gjithë jetën të paguajë dhe prapë kamatëvonesa mbetet

e papaguar. A ka ndonjë studim nga ju për të parë se çfarë do të bëhet me këta individë, që do të mbeten gjithmonë debitor pranë OSHEE-së?

Erjola Sadushi – Kamatë vonesa është një ndër elementet e trajtuar në kuadër të kontratës së miratuar nga enti Rregullator të furnizimit të shërbimit universal, është pjesë e konvergimeve që janë bërë gjerësisht jo vetëm me operatorin e shpërndarjes por me të gjitha grupet e interesit dhe në mënyrë të veçantë me shoqatën e konsumatorit, e cila është shprehur dhe përgëzuar punën e entit rregullator dhe nga mënyra se si janë regjistruar këto çështje.

Pse vendoset koncepti i kamatëvonesës? Dua të them që në të gjitha kontratat e rregulluara do të shihni që ka një koncept të kamatëvonesës. Nuk mundet që kompania të ekspozohet, sepse këtu duhen marrë në konsideratë edhe interesat e kompanisë, prandaj jemi këtu, për të ekuilibruar interesat e të gjitha palëve në sektor. Duhet të kuptojmë që kamatvonesa lidhet me ekspozimin që i bëhet kompanisë për produktin që ofron tek konsumatorët e energjisë elektrike dhe kjo lidhet edhe me afatin që u vendos nga Enti Rregullator në kuadër të prokurimit të humbjeve që bën operatori i shpërndarjes nga tregtarët. Domethënë është një element që ju siguroj se do ta gjeni në të gjitha kontratat e furnizimit dhe ky fenomen ekziston jo vetëm në Republikën e Shqipërisë, por në të gjitha vendet.

Çështja e faljes së kamatvonesave nuk mund të jetë objekt i vendimit të ERE-s, pasi ky është vendimi i pronarit të kompanisë, nëse do të ketë një vullnet të tillë, siç ishte edhe vullneti për marrëveshjen e shlyerjes në vite të kamatëvonesës së akumuluar. Normalisht, në rrethana të tjera, një subjekt do t'i duhet ta ndërpresë energjinë. Pas afatit të vendosur ka një periudhë faturimi 30-ditore dhe 30 ditët e tjera janë koha e kryerjes së pagesës. 30-ditëshi i tretë është kundrejt kamatëvonesës. Në rrethana të tjera kompanisë i lind e drejta të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.

Në gjykimin tonë kompania ka gati 5 vjet që aplikon marrëveshjet afatgjata që i vijnë në ndihmë dhe shmangin pikërisht ndërpretjen e furnizimit me energji elektrike në këta konsumatorë. Ajo që dua të them është se, në të gjitha rastet, i kemi kërkuar kompanisë ankesat e mbartura në faturimet e periudhës 2011-2012, se ajo është periudha më problematike në faturime, gjithashtu i kemi kërkuar që në çdo rrethanë ndërprerja e furnizimit me energji elektrike të bëhet vetëm pasi të jenë verifikuar të gjitha rrethanat e mënyrës se si janë faturuar këta klientë. Aty ku dokumentacioni nuk është i plotë i është kërkuar kompanisë të mos bëjë ndërprerje të energjisë elektrike.

Në këtë mënyrë besoj se i kemi shërbyer edhe interesave të kompanisë, por mbi të gjitha atyre të konsumatorit shqiptar.

Nëse më lejohet, do të doja të shpjegoja edhe pyetjen në lidhje me pagesat 180-ditëshe, që u vendosën nga ERE-ja dhe që ishte çështja që u ngrit më shumë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë në prezantimin që u bë në seancën degjimore në këtë komision. Dua të them është ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” ai që përcakton detyrën e ERE-së për të miratuar rregullat dhe procedurat e e blerjes së energjië elektrike nga OSHEE-ja dhe nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. Të dy këta operatorë operojnë me të njëjtat rregulla dhe çështja e pagesave dhe, nëse do të flasim në termat e akteve të tjera përtej ligjit për sektorin energjisë elektrike, ka një ligj në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 48 i vitit 2014 “Për pagesast e vonuara”, i cili përcakton një afat 90-ditor dhe unë them se është pikërisht ERE-ja, e cila në konsultimet që janë bërë me grupet e interesit përfshirë OSHEE-në, OST-në, shoqatat e furnizuesve, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, ka konsideraur se çështja e pagesave duhet të adresohet në kuadër të kësaj rregulloreje dhe se ERE-s i kërkohet të miratojë në kuadër të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Afati në kushte normale i miratuar nga Enti Rregullator në rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve është ai prej 90 ditësh. Këtu kemi marrë parasysh kohën e blerjes së energjisë nga OSHEE-ja, kohën e faturimit, marrjen e pagesave nga konsumatorët dhe hallka e tretë, pagimin i energjisë nga OSHEE-ja tek tregtarët. Për sa i përket 1800-ditëshit, ky ishte, në njëfarë mënyre një akomodim i problematikave që shfaqti risku i hidrologjik, për të cilin po flasim. OSHEE-ja u ekspozua në sasisë më të ulëta të blerjes së energjisë nga KESH sh.a dhe blerjes më të madhe të energjisë qoftë për qëllim të por edhe të furnizimit universal.

Në këtë shqetësim OSHEE-ja, e cila ekspozohet në kosto të larta për shkak të afatit 90-ditor, e bëri të qartë që këto pagesa nuk mund të kryeshin në një afat të tillë dhe se do të kishte penalitete për kamatëvonesat. Si të tilla akomodua këto periudhë tranzitore. Por afati është gjerësisht i konsultuar që në rregullore, sespe 180 ditëshi është një veprim tranzitor. Standardi është 90 ditë.

Ilir Beqaj – Unë nuk marr përsipër të bëj kungulleshkën, 90, 85 apo 95, por a mund të më thoni dy ligjet që cituat?

Erjola Sadushi – Ligji “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 19, germën hezitonj ta them, sepse duhet të kisha ligjin me vete, si dhe ligji nr. 48 i vitit 2014 “Për pagesat e vonuara dhe veprimet kontraktuale të tregtarëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili nuk lejon pagesa më shumë se 90 ditë, përveç se kur ka marrëveshje mes palëve.

Pikërisht në emër të këtij ligji kemi adresuar problematikën që OSHEE sh.a ngriti në ERE-ja dhe vendosëm afatin prej 180- ditësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Procedura e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit të energjisë elektrike, në kuptim të ligjit për sektorin e energjisë, miratohet nga ERE-ja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, rregullorja që po trajtojmë është për mbulimin e humbjeve, edhe afati 180-ditësh është për mbulimin e humbjeve, pra për kontratat e lidhura nga OHEE-ja me tregtarët për nevojat e mbulimit të humbjeve. Pjesa tjetër është energjia që OSHEE-ja blen nga KESH-i me kontratë të rregulluar në kuptim të vendimit nr. 244 të vitit 2016 “Për detyrimet e shërbimit publik”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blen diferencën dhe funksionon në kuadër të kontratës së furnizimit që ka me KESH-in, diferencën e mosfurnizimit nga kontrata me FSHU-në e rregullon në kuadër të asaj marrëdhënie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

ERE-ja e ka miratuar rregulloren për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kemi shtrirë, vendimi i marrë nga ERE-ja është vetëm në kuptim të rregullores “Për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe të transmetimit”, nuk është për prokurimet e tjera të OSHEE-së. Ky është vetëm për këtë rregullim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është kërkuar asnjëherë nga ERE-ja të zbatojë këtë apo atë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka kufizime nga ERE-ja në këtë drejtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vendimi nr. 46 i marrë nga ERE-ja, në mos gaboj, i këtij viti, adreson vetëm energjinë e prokuruar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, se në rrjetin e transmetimit vijon të ngelet i njëjti standard, pasi kjo ishte e vetmja problematikë që hasi OSHEE-ja në kuadër të riskut hidrologjik për të cilin po diskutojmë. U ekspozua në sasinë më të madhe të blerjes së energjisë.

Ilir Beqaj – Nga si e lexoj ligjin e vitit 2014, më duket se po e keqpërdorni. Ky ligj është vetëm për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore, se kështu e ka dhe titullin ligji.

Këtu nuk po flasim për pagesa të vonuara, sepse ju më thatë që përdorni afatet bazuar në dy ligje, kurse ky këtu nuk është për marrëdhëniet tregtare, por për raste vonesash. Kur fillon historia e një blerjeje nuk paragjykohet me vonesë.

Erjola Sadushi – Atëhere, ne e cituam edhe më parë, llogaritja e afateve nga ERE-ja prej 90-ditësh ka marrë në konsideratë kohën e kryerjes së pagesës nga OSHEE-ja tek tregtarët...

Ilir Beqaj – Më fal, edhe një herë, nuk po të kërkoj algoritmin pse të ka dalë 90 ditë, nuk i hyj fare se nuk është qëllimi im ky, sepse nuk jam specialist që të them del 88 apo 92. Unë dua të di kush të jep të drejtën të caktosh afat, sepse ky ligj, që ju ma dhatë si ilustrim, nuk ta jep, ose, të paktën mua nuk më mbushet mendja.

Erjola Sadushi – Nuk kemi përdoruar këtë si afat.

Ilir Beqaj – Këtë ligj unë nuk e njihja, ju ma cituat, kështu që mos thoni “nuk e kam përdorur”. 48-ën ma thatë ju, se unë nuk e dija.

Erjola Sadushi – Edhe një herë, ju pyetët nëse ka ndonjë rregullim tjetër ligjor përtej ligjit të sektorit të energjisë dhe ne ju thamë se ligji për sektorin e energjisë ka ngarkuar ERE-n për të miratuar rregullat dhe procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit të energjisë. Kjo është ajo që kemi bërë. Të gjitha llogaritjet dhe dispozitat e vendosura në atë rregullore lidhen me legjislacionin në sektorin e energjisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj ndjesë atëherë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo nuk u turbullova. Pyetja ishte, nëse mund të kthehemi prapa, pyetja ishte: A ka legjislacion tjetër që rregullon pagesat në vendin tonë? Unë jua citova. Kërkoj ndjesë nëse bëra konfuzion!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më pyetët a ka ligj tjetër dhe po ju them që ky është ligji tjetër, por nuk e kemi rregulluar rregulloren tonë mbi këtë ligj.

Petrit Ahmeti – Për mua është i rëndësishëm fenomeni që ka ndodhur, sepse ka gjeneruar një përfitim për konsumatorët dhe kjo është ajo që duhet kuptuar në radhë të parë. Afati kohor 3-mujor është caktuar mbi bazën e një kërkesë të OSHEE-së duke shpjeguar edhe arsyet financiare pse ata duhet të vononin pagesat pasi pamë dhe analizuam që nuk do të kishte probleme qoftë nga pikëpamja e interesave të tregtarëve, qoftë nga pikëpamja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja ta mbaroj!

Ilir Beqaj – Jo, sepse po hyjmë në detaje. Mua nuk më intereson a del 85 apo 95, kjo është çështje teknike.

Petrit Ahmeti – Dakord, por edhe mua më intereson të shpjegoj diçka, se këtu jemi në publik.

Ilir Beqaj – Pse vini afat? E kam bërë këtë pyetje edhe atë ditë kur ishte zotëria.

Petrit Ahmeti – Sepse është e drejta jonë që mund ta vëmë edhe këtë afat nëse kemi një dialog me kompaninë dhe ajo ka nevojë të ketë një situatë të shëndetshme financiare.

Ilir Beqaj - Kompania e zgjidh me palët.

Petrit Ahmeti – Jo, sepse ka nevojë për ndërhyrjen tonë. Edhe qenkemi edhe nuk qenkemi rregullatorë? Ne zgjidhim një konflikt mes tregtarëve dhe kompanisë, e cila erdhi në ERE dhe, natyrisht, siç thotë edhe kolegja, është një shërbim publik tek i cili ne....

Ilir Beqaj - Kjo e ka gjenezën te një barrierë që e keni vënë ju. 90-tën e keni vënë ju, sepse po të ishte pa afat, palët do ta zgjidhnin vetë, e dinë vetë ata si e zgjidhin.

Petrit Ahmeti - Ne nuk po diskutojmë po të ishte një legjislacion tjetër, por po diskutojmë që mbi këtë bazë ligjore ne do të merrnim vendimin tonë për të modifikuar këtë gjë dhe pjesa e diskutimit për shtyrjen e 3-mujore të pagesave lidhet me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Ahmeti - Më fal, por dua ta them këtë, se unë nuk do të them çfarë do ti. Po ju them se kjo pjesë e pagesës e ndihmonte këtë kompani dhe i jepte menjëherë një frymëmarrje në lidhje me gjendjen financiare dhe problematike që ka me likuidimin e pagesave. Pse, sepse nëse nuk do të ndodhte ky fenomen, do të kishte një mospagim për një muaj dhe do të rëndohej me kamata nga marrëdhëniet tregtare që kishte me këta furnizues. Këtu flasim për një treg dhe për një përfitim të konsumatorëve.

Ilir Beqaj – Se çfarë mendon ti e thua te raporti, kurse pyetjes sime do t'i përgjigjesh për sa kërkoj unë.

Petrit Ahmeti – Dakord. Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Baraj ka një pyetje.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Sektori që ju mbuloni ka një rëndësi shumë të madhe dhe duket qartazi që është shumë kompleks, se keni të bëni me prodhimin, me tregun, me mbrojtjen e konsumatorit, me vlerësimin e burimeve financiare dhe njerëzore, etj. Ajo që më bën përshtypje në atë material është se, duke pasur parasysh që ky sektor ka impaktin më të madh në drejtim të dëmtimit të

mjedisit, në këtë material nuk ka pothuajse fare një vlerësim apo një rol tuajin për të dhënë një opinion për këtë problematikë.

Niko Peleshi – Ka edhe një pyetje nga zoti Marto. T'i mbledhim të gjitha pyetjet zoti Ahmeti pastaj përgjigjuni!

Andrea Marto – Faleminderit për prezantimin dhe përgjigjet e pyetjeve!

Unë kisha diçka në lidhje me fushën e energjisë që prodhohet nga energjia diellore. Si i gjykoni ju kushtet e tregut? A janë të favorshme për zhvillimin në këtë sektor, apo jemi mbrapa në krahasim me vendet e tjera të rajonit?

Faleminderit!

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Po zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti – Në lidhje me pyetjen e zotit Baraj mund të them që në të gjitha kërkesat e licencave që japim ekziston kërkesa për problemet e mbrojtjes së mjedisit, domethënë të gjitha objektet prodhuese të energjisë elektrike duhet të respektojnë kërkesat mjedisore. Kjo është një kërkesë e shprehur drejtpërdrejt në kërkesat që bëjmë për licencimin e kompanive.

Besnik Baraj – Ju a keni ndonjë rol monitorues në këtë drejtim?

Petrit Ahmeti – Ne kemi një program monitorimi dhe jo vetëm të ekzekutimit të projektit, por edhe në vazhdimësi, ama jo drejtpërdrejt për këtë problem. Në programin e monitorimit që bëjmë për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike është edhe pika që kemi kërkuar për pjesën e mbrojtjes, ose leja mjedisore që japim.

Besnik Baraj – Në kushtet kur dihet që në Shqipëri nuk respektohen si duhen standardet e mjedisit, a keni pasur raste kur keni bërë kontestime apo oponenca, të cilat duhen vlerësuar nga institucionet përkatëse?

Petrit Ahmeti – Ne kemi pasur pak korrespondenca për këtë problem, por unë dua të them edhe diçka tjetër: është e rëndësishme që kërkesat për mbrojtjen e mjedisit të jenë në dokumentacionet tona, por jo gjithmonë ne jemi të detyruar të shkojmë në mënyrë strikte për të mbajtur përgjegjësinë e fenomenit të ruajtjes apo mosruajtjes së mjedisit. Nga pikëpamja ligjore i kërkohet kompanisë që të respektojë dhënien e licencës, pasi është një parakusht.

Në lidhje me energjinë diellore ka një projekt nga qeveria, e cila ka përcaktuar një kuotë apo një sasi të caktuar për implementimin e paneleve diellore. Unë nuk dua të zgjerohem shumë, sepse nuk është një problem vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera, të cilat i kanë zbatuar këto projekte të energjisë diellore. Ka një problem teknik me dispeçerimin e këtyre energjive, sepse kanë një probabilitet të caktuar dhe natyrisht duhet që

edhe sistemi të krijojë fenomenet e balancimit të tij me prezencën e energjisë diellore. Në teknologjinë e tyre akoma nuk është gjetur pjesa e akumulimit të këtyre energjive, në kuptimin e prodhimit, pra ta akumulosh edhe ta nxjerrësh në treg në një moment të caktuar kur ti mund ta komandosha brenda 24 orëve. Aktualisht ne kemi dhënë disa të drejta dhe kemi licencuar disa kompani, të cilat kanë marrë të drejtën e ndërtimit të këtyre impianteve nga Ministria e Energjisë. Por natyrisht, sipas të gjitha problematikave të deritanishme të trajtuara, ka një limit të fuqisë së instaluar të këtyre impianteve fotovoltaike. Ajo që ne mund të rekomandojmë është një teknologji që njihet në të gjithë botën dhe duam gjithmonë të ngacmojmë e të propozojmë përdorimin e tjegullave fotovoltaike, që janë celula fotovoltaike, që prodhohen për nevoja të banesave dhe familjare.

Ndërkohë ka një nismë nga Ministria e Energjisë për instalimin e paneleve fotovoltaike në të gjitha çatitë e ndërmarrjeve industriale, të cilat kanë sipërfaqe shumë të mëdha dhe mund t'i shfrytëzojnë për montimin e paneleve fotovoltaike. Gjithsesi ka një kusht që fuqia e instalimit të tyre nuk duhet të kalojë fuqinë e kërkuar, pra, në njëfarë mënyre të jenë vetëprodhues. Kjo është një nga ndihmesat më të mira që mund t'u jepet.

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Nëse ai nuk do të kalojë fuqinë e instaluar, nuk do të eksportojë, nuk do të hedhë në rrjet energji të prodhuar, pra nuk do të jetë një prodhues. Nëse kjo nevojë do të vijë, dhe kjo lidhet me politikat ka qeveria dhe i gjithë sektori, atëherë ne do të jemi të detyruar të miratojmë një legjislacion, që lidhet me vendosjen e një çmimi për energjinë e tepërt, që ai do të prodhojë. Nuk do ta përdorë vetë, por do ta hedhë në rrjet.

Këto janë eksperiencat e të gjitha vendeve të Europës perëndimore, që ne aktualisht i kemi dhe i dimë, por, në njëfarë mënyrë kërkojnë edhe një përmirësim të legjislacionit në fuqi, por mbi bazën e këtyre kërkesave.

Niko Peleshi- Edhe unë desha të të bëja këtë pyetje zoti Ahmeti. Pra, ku jemi ne me mundësimin e prodhuesve vetjakë për të shitur tepricën e energjisë? Sepse kjo mbase do t'i jepte një shtysë edhe përdorimit të burimeve të tjera të rinovueshme, siç është energjia e diellit për përdorime të industrisë dhe individëve.

Në fakt, kemi diskutuar në komision edhe për çështjen e audituesit të energjisë dhe u tha se kuadri rregullator është gati, por duhet të ndërmarrë disa hapa rregullatori. Pra, a jemi në rregull me kuadrin rregullator? A duhet të bëjmë përmirësime të kuadrit rregullator dhe ligjor, apo është thjesht çështje investimesh infrastrukturore?

Petrit Ahmeti - Praktikisht ne jemi pjesë e një grupi pune pranë Ministrisë së Energjisë për diskutimin e të gjitha problematikave dhe dhënies zgjidhje, sepse është një

problem kompleks që ka nevojë të diskutohet nga të gjitha këto institucione, por unë mund t'ju them se nga ana jonë nuk ka asnjë lloj problematike për miratimin e legjislacionit që do të krijojë një shtrat të përshtatshëm për miratimin e projekteve të energjisë fotovoltaike. Mosshfrytëzimi i energjisë diellore në Shqipëri ku ka 300 ditë me diell, është një lloj paradoksi. Por edhe kjo ka arsytet e veta në lidhje me problemet që ka sistemi energjetik, qoftë në shpërndarje, qoftë në transmetim.

Pra, bëhet fjalë për energji dhe kapacitete, të cilat futen në mënyrë të paplanifikuar në monitorimin e flukseve të energjisë elektrike. Megjithatë është plotësisht i drejtë sugjerimi që ju jepni. Ne si rregullator jemi të aftë për të miratuar bazën legjislative për funksionimin e këtij tregu të energjisë elektrike.

Niko Peleshi - Ne do të ndërmarrim një iniciativë për ta shtyrë përpara duke filluar me një dëgjese me OSHEE-në, ku do të jeni të ftuar edhe ju.

Në lidhje me kuadrin ligjor ne kemi rol për të luajtur, ndërsa çfarë duhet investuar në infrastrukturë nga OSHEE-ja të paktën të kemi një plan dhe një datë që të mos ecim kuturu, sepse nga njëra anë bëjmë apel për eficiencë të energjisë, nga ana tjetër, edhe kur ka iniciativë vetjake, ne nuk i ofrojmë kushte, sepse mungon kuadri ligjor.

A keni pyetje të tjera?

Kam idenë se një pyetje e zotit Beqaj ka mbetur pa përgjigje.

Ilir Beqaj - Pse u bë ndryshimi i metodologjisë në maj dhe pastaj pse i dhatë fuqi prapavepruese?

Erjola Sadushi – Kjo metodologji ka qenë pjesë e konsultimeve me grupet e interesit. Gjithashtu, nuk ka fuqi prapavepruese dhe, nëse do të lexoni vendimin e Entit Rregullator, nuk do të gjeni një fjalë të tillë, këto janë veprime që janë kryer nga OSHEE-ja, nuk janë në kuadër të vendimit nr. 144 të vitit 2018 të Entit Rregullator.

Metodologjia e furnizuesit të mundësisë së fundit nuk është metodologjia e OSHEE-së, sot është OSHEE-ja, në një kohë të dytë, mund të jetë kushdo tjetër i dalë nga gara që do të duhet të zhvillohet për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit dhe merr në konsideratë ndarjen e llogarive. Aktualisht, nëse zhvillohet aktiviteti i furnizuesit nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe merret në konsideratë ndarjen e llogarive të aktivitetit që lidhet për furnizimin e konsumatorëve që furnizohen nga shërbimi universal dhe nga aktiviteti që lidhet me furnizimin e mundësisë së fundit, do të thotë që OSHEE-ja për nevojat e furnizimit të konsumatorëve universalë, blejnë energji nga KESH sh.a dhe, natyrisht, është me një çmim më të lirë, ndërkohë që energjia që merret për qëllime të furnizimit të mundësisë së fundit është energji që blihet nga tregu.

Kjo u reflektua në ndryshimet që u bënë në metodologjinë e furnizuesit të mundësisë së fundit. Pra, u mor çmim reference për blerjen e energjisë për furnizuesin e mundësisë së fundit jo çmimi i blerjes nga KESH-i, sepse edhe KESH-i OSHEE-në nuk e faturon me çmimin e FSHU-së për çdo energji që është jashtë kontratës me FSHU-në.

Një element tjetër i shtuar ishte vendosja e detyrimit të OSHEE-së për të përcaktuar kostot administrative, që lidhen vetëm me shërbimin e furnizuesit të mundësisë së fundit dhe kjo ka të bëjë me devijimet në programet e furnizimit me energji elektrike.

Këto janë rrethanat që çuan në saktësimin e formulës së mënyrës së llogaritjes së çmimit të përcaktimit të furnizuesit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Ilir Beqaj - Po, pra, por prodhoi 19 lekë çmim.

Shqetësimi na ka ardhur në muajin nëntor, nga një sipërmarrës nga Fieri, që prodhonte tulla.

(Diskutim pa mikrofon)

Rajmonda Islamaj – Më falni, dua të bëj një qarim!

Normalisht çmimi mesatar muaj për muaj për vitin 2018 ka qenë rreth 12.04 lekë. Ka oshiluar nga 9.5 në 11, 12, 16. 19 nuk ka. Kur pamë ankesën e këtij konsumatori, që u drejtua edhe në ERE, shkuam bëmë monitorim edhe në OSHEE dhe vumë re që OSHEE-ja, përtej metodologjisë që ERE kishte miratuar për përcaktimin e këtij çmimi, pra, çmimi i blerjes nga tregu, jo nga KESH-i, sepse ky ishte detyrimi...

Ndaj, ashtu siç tha edhe zonja që ne i rikompozuam detyrimet e OSHEE-së në mënyrë që të mos kalonte kostot e blerjes së energjisë së këtij grupi të konsumatorëve të konsumatorët që shërbehen, të themi të familjarët, ose të konsumatorët e të njëjtit grup, që çmimin e kanë 9.5 të miratuar nga ERE.

Kështu që kur bëmë monitorimin pamë çfarë bën OSHEE-ja. Ajo ka miratuar edhe energjinë në pikë që e çonte çmimin nga 12 në 13, 14 apo nga 16 në 19. Vetëm një vit, çmimi i energjisë ka qenë tepër i madh, në periudhën e thatësirës rreth 16 lekë për muajt tetor – nëntor, për të cilën urdhëruam OSHEE-në të bënte korrigjimet e të gjitha faturave për këtë grup konsumatorësh.

Gjithsesi, desha të sqaroj që metodologjia bazuar në çmimin e tregut do t'i jepte mundësi liberalizimit më tej të tregut, sepse këta konsumatorë, pavarësisht se nuk janë kënaqur nga ky çmim që duket tejet i lartë, por OSHEE-ja kështu e ka prokuruar, sepse ka një procedurë prokurimi dhe e tillë ka dalë nga tenderi, atëherë janë shumë të lirë, pra, nuk është një goditje për to, por një incentivim i butë që të dalin në treg dhe ta zgjedhin vet

konsumatorin, sepse normalisht bëhet edhe një barrë për OSHEE-në dhe ajo, siç u tha, nuk demonstroi asnjëherë që kosto të kishte një njësi jo vetëm për të blerë energjinë, por, po të mbante kostot e veçanta për to, apo faturimet e disbalancave ishte e vështirë, në 1 milion e 200 mijë konsumatorë, janë edhe këta 35 të tjerë, kështu që janë shumë të lirë të dalin në treg dhe ta prokurojnë me çmime ndoshta më të ulëta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të rëndësishëm, por kanë zgjidhje. Këta konsumatorë të këtij tipi kanë zgjidhje të dalin. Një nga çuditë është që nuk kanë dalë, duket sikur janë komodë të qëndrojnë në OSHEE me ato kushte furnizimi, thjesht disbalancat ndoshta që ato shkaktojnë janë më të larta, por...

Për sa i përket çmimit të vendosur, se ju e përmendët me të drejtë kur thatë se vendosët një çmim tavan, po, në dysheme jo më e vogël se 9,5. Çfarë pamë? Të njëjtët konsumatorë në këtë 35 kilovoltë çmimi i miratuar nga ERE, bazuar në kosto sipas këtyre aktiviteteve, është 9,5 lekë. Pamë që kishte kosto më të ulëta.

Pra, kur OSHEE-ja (nuk themi dot që dështoi) nuk i justifikoi saktësisht kostot e saj pikërisht për këtë grup klientësh, vumë një tavan në mënyrë që kostot e tyre të mos transferoheshin te konsumatorët e rregulluar.

Këtu është problemi. Qoftë edhe ai çmimi i lartë, desha të sqaroj edhe një moment, se u kritikua që themi se mund të kemi

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në të vërtetë mund të diskutohet si *cros apsidi*, si midis klasave të konsumatorëve e ka lejuar ndoshta edhe BE-ja që të themi se brenda klasës nuk duhet të ketë, pra familjari me familjarin nuk duhet të ketë *cros apsidi*, por kjo, sepse ne kemi bërë ndër vite, në mos të kishte flokturacion të çmimeve herë të larta dhe herë të ulëta për të mbrojtur familjarët.

Lidhur me tensionin e ulët, mund të them se ka një sërë konsumatorësh, të cilët nuk arrijnë dot të zgjedhin furnizuesin. Për këtë arsye, ne kemi përdorur disa alokime të kostove, në mënyrë që energjia, që prodhohet nga KESH-i, të alokohet në pjesën më të madhe për konsumatorët e pambrojtur. Prandaj, çmimet e abonentëve jofamiljarë janë më të larta.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – Tendenca është që vetëm një pjesë e popullatës do të ketë një treg të rregulluar. Ne ndodhemi para një vështirësie dhe duhet të kuptojmë që këta konsumatorë, që janë të lidhur me linjën 35 kilovolt, natyrisht ne u kemi relatuar një çmim, por, për të mbështetur edhe politikat e zhvillimit të sektorit, ata normalisht duhet të dalin në treg të lirë.

Ata nuk kanë interes për momentin, sepse çmimi, që ata e gjejnë tek tregtarët, është relativisht pak më i lartë se sa çmimi që ata...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është problemi! Madje, ne kemi edhe një vështirësi tjetër, të cilën duhet ta propozojmë edhe për konsumatorin, sepse në fund të këtij viti ata duhet të ikin dhe nuk do të furnizojnë më.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – Unë mendoj në mënyrë empirike, që çdo tregtar duhet të paguajë pak më shumë se kjo që keni caktuar ju.

Rajmonda Ismailaj – Po.

Ilir Beqaj – Si po?!

Rajmonda Ismailaj – Për këtë arsye ata nxiten që të dalin në treg, në mënyrë që të mos rregullohen më nga OSHEE-ja. OSHEE-ja duhet të kontrollojë vetëm 04-ën.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ilir Beqaj – Unë e kam këtu një për një analizën e taksave, ndaj u qoftë hallall tregtarëve të energjisë, që i kanë normat e fitimit me 60% apo me 70%.

Niko Peleshi - Po, zonja Gjermani.

Më pas fjalën e ka zoti Bici.

Eglantina Gjermani - Faleminderit!

E vlerësoj prezantimin dhe punën tuaj, por edhe përgjigjet e pyetjeve!

Diçka që u vlerësua nga relatori, të cilën unë dua ta theksoj në mënyrë të veçantë, është kuadri i mbrojtësve të konsumatorëve. Ju keni miratuar një kuadër për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe planin e masave të OSHEE-së për respektimin e të drejtave të klientit për furnizimin me energji elektrike, i cili identifikon qartë përgjegjësitë e furnizuesit në kuadër të detyrimit të shërbimit publik. Për mua kjo është një arritje. Unë kam një sugjerim, por po e bëj në formën e një kërkesë, e cila patjetër duhet të jetë edhe në rezolutën, që ne do të diskutojmë dhe do të miratojmë si komision. Ju duhet të keni një rol proaktiv në monitorimin dhe në zbatimin me përgjegjësi dhe rigorozitet të kësaj gjëje.

Gjithashtu, dua të bëj edhe një vërejtje. Në vitin e kaluar unë kam sugjeruar, gjë që është bërë pjesë e rezolutës, që ne si komision duhej të informohemi në mënyrë periodike, jo thjesht njëherë në vit, siç bëni ju, pikërisht për mbrojtjen ndaj konsumatorëve, për mënyrën se si trajtohen dhe si adresohen të gjitha kërkesat dhe ankesat e tyre për një çështje kaq jetike dhe kaq të ndjeshme. Ne të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se numri i ankesave është i lartë.

Sipas një vendimi që ka nxjerrë Kuvendi, unë di se ju duhet të raportoni në mënyrë periodike dhe e keni detyrim, por unë dua ta ritheksoj se për këto çështje ne vërtet jemi të interesuar të marrim informacion në mënyrë periodike, edhe në mënyrë konkrete se si adresohen dhe çfarë mund të bëjmë ne si komision parlamentar, nëse ka hapësira apo nevoja për të ndërhyrë, në mënyrë që përmirësojmë një ligj apo të monitorojmë institucionet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Ahmeti – Ekziston një shqetësim i disa subjekteve koncesionare, të cilat kanë miratuar koncesionet, por nuk kanë miratuar lejet e ndërtimit të hidrocentraleve nga AZHT-ja. Nga informacionet që kam është një numër i konsiderueshëm hidrocentralesh që presin dritën jeshile për ndërtimin e tyre.

Kur flasim për energjinë diellore, jam dakord se nuk ka kuadër ligjor, por për këtë kategori përse nuk jepet drita jeshile për ndërtim, kur kohët e fundit jemi kritikuar nga organizmat ndërkombëtarë për ritmet e ulëta të energjisë së pastër kryesisht nga uji dhe energjia diellore.

Për mendimin tim, por edhe nga shqetësimet e atyre që më kanë kontaktuar, administrata shtetërore po vepron avash. Këtu nuk bëhet fjalë për ato koncesione që kanë probleme me mjedisin dhe me dokumente të tjera, por për ato që janë në rregull me ligjin dhe me të gjitha, të cilave nuk u jepet e drejta për ndërtim.

Maksim Shuli – Problemi që ngritet do të jetë në fokusin e punës tonë, si për ta diskutuar, ashtu edhe për ta adresuar. Në një farë mënyre është bërë një përmirësim cilësor i punës jo vetëm nga Enti, por edhe nga politikat e zhvillimit të qeverisë që lidhet me të drejtën e konsumatorëve, të cilat përpara, fatkeqësisht, nuk janë trajtuar në këtë formë.

Unë dua t'ju falënderoj për mundësinë që na jepni për të dialoguar, ndoshta duhet bërë më shpesh për trajtimin e këtij problemi, sepse mund të ketë nevojë jo vetëm për mbështetje ligjore, por edhe për mbështetje në tërësi, në mënyrë që konsumatorët ta ndiejnë veten të mbrojtur, sepse ka një institucion dhe një politikë që i mbron dhe kjo është e nevojshme.

Kam edhe një gjë që dua ta theksoj për numrin e ankesave në Entin Rregullator nga konsumatorët, të cilat kanë pësuar rënie drastike. Për këtë, në radhë të parë, është një punë korrekte dhe shumë e mirë nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili e ka vënë këtë shërbim në fokusin e vet. Kjo lidhet jo thjesht me shërbimin karshi klientit, por edhe në moskrijimin e debive të panevojshme dhe të parregullta. Kjo është ajo çfarë mund t'ju them në lidhje me këtë problem dhe me këtë pozicion të Entit Rregullator.

Në lidhje me problemin për ndërtimin e objekteve të reja, unë mund t'ju them se nuk ka asnjë aplikues që ka ardhur në Entin Rregullator, sepse detyra e Entit është të licencojë. Të drejtën për koncesion e japin institucionet e tjera, ndërsa ne kemi të drejtën dhe detyrimin për të licencuar. Pra nuk ka asnjë aplikim në Entin Rregullator, i cili të ketë kaluar afatin minimal dhe të mos jetë licencuar nga ana e Entit. Ky është një problem që ndoshta duhet adresuar diku tjetër, pa dashur të vendos drejtimin e kësaj adrese, por ne nuk kemi asnjë kërkesë ose të drejtë koncesionare të pa licencuar nga Enti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Statkrafti ka aplikuar për implementimin e energjisë diellore, duke menduar vendosjen e paneleve diellore në sipërfaqen e rezervatit ku ata kanë ndërtuar hidrocentralin. Kjo është një teknologji e njohur dhe që aplikohet në çdo vend të botës, por problematika me këto aplikime është në lidhje me çmimin e energjisë diellore të prodhuar, të cilën ne po i analizojmë dhe shumë shpejt do të marrim një vendim për vitin që vjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e përcaktuar në ligj deri në 2 mega, pra licencimi nuk jepet për më shumë se dy mega, për çdo aplikim që bëhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne do të vendosim çmimin për impiantet që prodhojnë deri në 2 mega, e energjisë elektrike me të cilën OSHEE-ja do t'ia blejë energjinë e prodhuar. Kjo është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Ahmeti - Mbi 2 mega, e thënë ndryshe duhet të dalë në treg të lirë, nuk ka detyrim OSHEE-ja t'ia blejë energjinë elektrike, siç janë hidrocentralet e vogla, që fatkeqësisht kanë mbetur ashtu.

Të mos keqkuptohemi, këto janë panele lundruese në rezervuarin e hidrocentralit. Këto panele mund të instalohen në çati apo në tokë, janë lundruese, kjo është teknologji e njohur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai do të zbatojë rregullat dhe ligjet shqiptare që kemi ne.

Niko Peleshi - Ka edhe një pyetje zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Kam merak çështjen e kabinave edhe për një arsye tjetër, në lidhjen e energjisë me biznesin na del një nga treguesit më të këqij në *Doing Business*. Nuk është se ne duhet të rregullojmë një procedurë vetëm për të dalë më mirë në klasifikime, por *Doing Business*, duam apo jo, është bërë një tregues që shihet nga investitorët nëpër botë. Ai nuk u

hyn detajeve se nga 10 tregues që ka *Doing Business*, ka 1 pikë të energjia, ai mund të mos ketë fare nevojë për energjinë.

Pse e thashë këtë? Derisa të dalë rezoluta jonë mund të shkojë edhe një muaj e gjysmë, deri sa të botohet, a mundeni që këtë pikë, për rregullimin e kabinave sot e mbrapa ta filloni pak më shpejt si punë me OSHEE-në, me ministrinë, me ne apo me cilin të doni. E kam si një lloj kërkesë, nuk dua përgjigje, e kisha si merak, pastaj e çmoni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Ahmeti – Nuk është thjesht vetëm problemi i Entit Rregullator, se fatkeqësisht, kërkoj ndjesë që po e them këtë gjë, po konceptohet sikur ne paskemi një rol. Nuk na mungon vullneti që ta kryejmë atë rol nëse e kemi, por e biseduam bashkë, janë dy rrugë që duhet të zgjidhen, jo thjesht vetëm për ato që ndërtohen dhe për ato ekzistuese. Rruga tjetër është bashkëpunimi institucional. Ndoshta duhet të bëhet një bisedë më e rezervuar për t'i dhënë drejtim. Nga eksperiencia ime disavjeçare që kam në këtë sektor, nuk është problem kaq i madh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të falënderoj, sepse kjo është kërkesa ime finale duke mbyllur të gjithë pjesën e diskutimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Niko Peleshi - Do ta diskutojmë pas mbledhjes.

Nëse nuk ka pyetje apo koment tjetër, falënderojmë zotin Ahmeti, si edhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë të ERE-s për raportin, punën dhe rezolutën, për të cilën mund të takohemi përsëri!

Po, zoti Bitri.

Robert Bitri - ERE-ja duhet të marrë masat që komisioni të bëjë një vizitë jashtë shtetit, që ne të shikojmë institucionet e tyre homologe, meqenëse zoti Petrit është dhe nënkryetar i atij komisioni, të shihet mundësia t'i vizitojmë sesi e kanë të organizuar.

Niko Peleshi - Kjo është shumë e nevojshme.

Petrit Ahmeti - Falënderoj sugjerimin e bërë dhe marr përsipër që në pozicionin e zëvendëspresidentit të rregullatorëve të Mesdheut, të organizojmë një takim praktikisht me përfaqësuesit e rregullatorit italian.

Ky është propozimi im, ka mundësi edhe me rregullatorët e tjerë. Fatmirësisht ne jemi pjesë edhe e anëtarë të vendeve të Mesdheut, por edhe të Europës Juglindore për arsye të

vlerësimit, në njëfarë mënyrë, jo vetëm thjesht të pozicionit gjeografik. Këtë gjë unë do t'jua mundësoj, por dua të mos e refuzoni vizitën dhe takimin në Itali.

Niko Peleshi - Jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA